



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.38 dt.14.02.1997

**PER  
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER BLERJE  
FRIGORIFERESH, AUTOMJETE FURNIZIMI PER USHQIME, SI DHE  
NDERTIM MAGAZINE PER CERDHET E FEMIJEVE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.14.02.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje frigoriferësh, automjete furnizimi për ushqime, si dhe ndërtim magazine për çerdhet e fëmijëve dhe në mbështetje të nenit.14 të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

**V E N D O S I;**

1. Dhënie e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve për :
  - **fond për blerje frigoriferë shtëpiakë 900.000 lekë.**
  - **fond për blerje frigoriferë të mëdhenj tip banak për magazinë 360.000 lekë**
  - **fond për blerje automjet tip furgon 2 milion lekë**
  - **rikonstruksion mjedisesesh për një magazinë të artikujve ushqimore me vleftë 2 milion lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mjedisit, Drejtoria e Financës si dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve. Blerja do bëhet sipas ligjeve në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**ORHAN SAKIQI**

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**